

S T A T U T I

I SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT

"FED invest"

(Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e "FED invest", në datën 29 Prill 2017)

29.04.2017

Neni 1

Hyrje

SHKK “FED invest” është shoqëri kursim krediti (në vijim “FED invest” ose “shoqëria”), pa qëllim fitimi, e krijuar nga bashkimi me përthithje i 69 shoqërive të kursim kreditit, sipas listës bashkëlidhur këtij statuti. Në kuptim të këtij bashkimi, si dhe bazuar në Ligjin nr. 52/2016 “Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre”, përcaktohen kushtet dhe termat mbi organizimin dhe funksionimin e kësaj shoqërie.

Kudo ku në këtë Statut përmenden terma të tillë si Degë, Zyra e Marrëdhënieve me Anëtarësinë (ZMA), Njësi Bazë, Grup Njësie Bazë, etj., ato do të kenë të njëjtin kuptim që jep ligji dhe/ose aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 2

Emërtimi, Logo dhe Vula

1. Emërtimi i shoqërisë është SHKK “FED invest”.
2. Logo e shoqërisë është togfjalëshi “FED invest” në ngjyrë blu dhe të gjelbërt, të vendosura dy fjalët njëra mbi tjetrën. Togfjalëshi shoqërohet nga simboli i 4 hekzagonëve të lidhur së bashku në gjyrë të gjelbër dhe shigjetës së bardhë që kalon përmes tyre.
3. Vula e shoqërisë është në formë rrethi. Formohet nga logo e shoqërisë në mes, e cila rrethohet nga shkrimi “Republika e Shqipërisë” në pjesën e sipërme dhe “Shoqëria Kursim Kredi” në pjesën e poshteme.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr: Qemal Stafa, Pallati 9 katësh, nr.70, Tiranë. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme selia mund të transferohet kudo ku shoqëria kryen aktivitet.

Neni 4

Shtrirja territoriale

1. SHKK “FED invest” ushtron veprimtari në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Degëve të saj.
2. SHKK “FED invest” është shoqëri e zgjeruar. Kjo përcaktohet nga numri i madh i anëtarëve dhe shtrirja territoriale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së saj, shoqëria organizohet dhe hap adresa dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto adresa hapen ose mbyllen me vendim të administratorit.

4. Degët mbajnë emërtimin SHKK “FED invest” “Dega _____”, duke përcaktuar emrin e njësisë administrative territoriale ku e zhvillon aktivitetin ajo.

Neni 5

Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë

1. Qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - a) Bashkëpunimi ekonomik dhe social ndërmjet “FED invest” dhe anëtarëve të saj, me qëllim rritjen e mirëqënies së anëtarëve.
 - b) Bashkëpunimi dhe ndihma reciproke ndërmjet vetë anëtarëve.
 - c) Promovimi i një edukate financiare dhe ekonomike të anëtarëve të saj.
2. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është pranimi i depozitave dhe dhënia e kredive anëtarëve të saj.
3. Përveç kësaj, me miratimin e Bankës së Shqipërisë, shoqëria mund të ushtrojë edhe veprimtari financiare të tjera, të tilla si:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave.
 - b) Këmbimi valutor.
 - c) Qiraja financiare.
 - d) Shërbime të tjera financiare.
4. “FED invest” në përmbushje të qëllimit të saj, mund të ushtrojë edhe veprimtari jofinanciare.

Neni 6

Burimet financiare

Burimet financiare të shoqërisë janë:

1. Kapitali dhe rezervat.
2. Depozitat e anëtarëve.
3. Linjat e kredisë që shoqëria do të marrë nga bankat e nivelit të dytë apo institucionet financiare.
4. Donacionet e ndryshme, nga subjekte kombëtarë ose ndërkombëtarë.

Neni 7

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë së SHKK “FED invest” është pa afat. Asambleja e Përgjithëshme vendos për kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 8

Kapitali i Shoqërisë

1. Kapitali i SHKK "FED invest" përbëhet nga:
 - a) kontributet e anëtarëve;
 - b) fondet e donatorëve;
 - c) rezerva ligjore;
 - ç) rezerva staturore;
 - d) rezerva të tjera;
 - dh) fitimet/humbjet e grumbulluara;
 - e) rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme;
 - ë) fitimi ose humbja gjatë vitit në vazhdim.

2. Kapitali është pronë e SHKK-së dhe është i paguar dhe i shprehur në lekë.

Neni 9

Kapitali i paguar

1. Kapitali i paguar përbëhet nga tërësia e kontributeve të paguara nga çdo anëtar. Vlera e kontributit të paguar vendoset nga Asambleja e Përgjithëshme.
2. Kontributi i anëtarit në kapitalin e shoqërisë është i trashëgueshëm. Në këtë rast, trashëgimtari nuk e trashëgon të drejtën e anëtarësisë.

Neni 10

Teprica neto vjetore

Çdo vit, teprica neto e krijuar nga aktiviteti (diferenca pozitive e të ardhurave me shpenzimet), destinohet plotësisht për rezerva.

Përdorimi i tepricës neto vjetore miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 11

Rezervat

1. SHKK "FED invest" krijon rezervë ligjore, të paktën 50 për qind të tepricës neto vjetore të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 5 për qind të totalit të aktiveve të shoqërisë.
2. Shoqëria mund të parashikojë edhe krijimin e rezervave të tjera nga teprica neto vjetore.
3. Shoqëria përcakton rezerva rivlerësimi, të cilat nuk llogariten nga fitimi dhe që përfaqësojnë kundërpartinë e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme në kuadrin e rivlerësimit, me vendim të Këshillit Drejtues dhe në respektim të akteve ligjore në fuqi.
4. Rezervat e shoqërisë përdoren për mbulimin e humbjeve dhe nuk mund t'u ndahen anëtarëve të saj, në rastet kur shoqëria është në proces likuidimi ose kur anëtarët largohen prej saj.

Neni 12

Depozitat dhe sigurimi i tyre

1. "FED invest" pranon depozita nga anëtarët e saj, me apo pa afat të përcaktuar. Afati, përqindja e interesit, si dhe kushtet dhe modalitetet e tjera, përcaktohen nga Këshilli Drejtues.
2. Depozitat mund të tërhiqen nga anëtarët, sipas afateve dhe kushteve të rëna dakord në kontratë.
3. "FED invest" siguron depozitat e anëtarëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. "FED invest" është anëtar në skemën e sigurimit të depozitave pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave të Republikës së Shqipërisë, dhe respekton legjislacionin për këtë qëllim.

Neni 13

Kreditë

1. "FED invest" jep kredi për anëtarët e saj sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Drejtues, mes te cilave: shumat maksimale që mund të merren kredi, niveli i interesit, format e pranueshme të garancisë, kushtet për rikthimin, si dhe modalitetet e administrimit të detyrimeve.
2. "FED invest" mund t'u ngarkojë anëtarëve edhe shpenzime të tjera të arsyeshme që lidhen me procesin e kredidhënies.
3. Të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe penalitetet për mospagimin e kredisë sipas termave të rëna dakord mes palëve, formalizohen në kontratën e kredisë që lidhet mes shoqërisë dhe anëtarit kredimarrës.
4. "FED invest" krijon provigjone për kreditë në përputhje me aktet e miratuara për këtë qëllim.
5. Proçesi i kredidhënies dhe krijimi i provigjoneve, do të respektojnë kërkesat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

Neni 14

Investimet

1. "FED invest" mund të investojë mjetet e lira monetare, në respekt të akteve rregullative të brendshme dhe kërkesave të Bankës së Shqipërisë, në:
 - a) depozita pranë bankave të nivelit të dytë;
 - b) bono thesari të emetuara nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë;
 - c) asete fikse.

Neni 15

Anëtarësimi

1. Anëtar i shoqërisë është individ, mbi moshën 18 vjeç, ose personi juridik, i cili, përkundrejt pagesës së kontributit, fiton të drejtën e anëtarësisë, të drejtën të depozitojë paratë në SHKK dhe të përfitojë kredi prej saj, me qëllim përmbushjen e nevojave apo interesave të veta.
2. Individu duhet të gëzojë zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, si dhe të jetë rezident në zonën territoriale ku Dega e "FED invest" ushtron veprimtarinë, sipas përcaktimit në statut.

Neni 16

Pjesët e anëtarësimi/Regjistrimi

1. Shoqëria mban një regjistër elektronik me emrat e anëtarëve, zotërues të kontributeve të "FED invest". Në këtë regjistër pasqyrohen edhe datat e pagimit të kontributeve, si dhe data e kalimit të pronësisë nëpërmjet formave të njohura me ligj.
2. Anëtari i ri pajiset me kartën e anëtarësimi të "FED invest".

Neni 17

Humbja e anëtarësisë

1. Një individ pushon së qëni anëtar i shoqërisë:
 - a) Kur jep dorëheqjen.
 - b) Kur përjashtohet nga Këshilli Drejtues.
 - c) Në rast likuidimi vullnetar apo të detyruar të shoqërisë.
 - d) Në rast vdekje.
 - e) Në raste të tjera që mund të parashikohen nga aktet nënligjore të shoqërisë.
2. Çdo person që humbet anëtarësinë duhet të shlyejë menjëherë çdo shumë që ai i detyrohet shoqërisë.

Neni 18

Përjashtimi i anëtarit

1. Është e drejtë e administratorit të marrë vendimin për të përjashtuar një anëtar nga "FED invest", nëse ai vepron në kundërshtim me parimet e përgjithshme të shoqërisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e brëndshme të saj.
2. Vendimi i përjashtimit duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet me shkrim anëtarit.
3. Anëtari i përjashtuar ka të drejtë të apelojë për vendimin e marrë në Këshillin Drejtues. Ankimi bëhet me shkrim dhe duhet paraqitur brënda 10 ditëve nga marrja dijeni për aktin e përjashtimit. Ankimit i bashkëlidhet çdo dokument që shërben si provë për pretendimet e ankuesit.

Neni 19

Kthimi i pjesëve të kapitalit të paguar

1. Në rast të largimit, çdo anëtar ka të drejtë t'i kërkojë administratorit kthimin e kontributit deri në vlerën e paguar nga ai, në kapitalin e shoqërisë.
2. Megjithatë, për kthimin e kontributit merret për bazë edhe gjëndja financiare e ditës së fundit të qëndrimit të anëtarit në shoqëri. Pavarësisht datës kur anëtari ka depozituar kërkesën e tij për t'u larguar, ky kthim bëhet vetëm pasi Asambleja e Përgjithshme të ketë verifikuar se borxhet e SHKK "FED invest" janë mbuluar, dhe pagimi i kontributeve që duhen kthyer nuk zvogëlon vlerën neto të kapitalit, nën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e shumës maksimale.

Neni 20

Të drejtat e anëtarëve

Çdo anëtar i shoqërisë ka këto të drejta:

1. Të votojë për kandidaturat e Bordit të Njesisë Bazë, nga i cili del delegati që përfaqëson Njësinë/Grup Njësine në Asamblenë e Përgjithshme të "FED invest". Struktura e votimit dhe çdo modalitet tjetër është e përcaktuar në Kodin e Qeverisjes së "FED invest".
2. Të paraqesë kandidaturën për strukturat drejtuese të shoqërisë, duke siguruar më parë mbështetjen e anëtarësisë dhe respektuar Kodin e Qeverisjes së "FED invest".
3. Të përfitojë nga shërbimet e shoqërisë, sipas mënyrave të parashikuara në këtë Statut dhe në aktet e tjera të shoqërisë.
4. Të konsultojë pasqyrat financiare të shoqërisë të publikuara në Asamblenë e Përgjithshme, pasi depoziton kërkesën e argumentuar me shkrim tek administratori.
5. Të konsultojë çdo informacion apo dokument tjetër, që lidhet me marrëdhënien e tij me shoqërinë.

Neni 21

Detyrat e anëtarëve

1. Çdo anëtar i shoqërisë:
 - a) Ka për detyrë të respektojë legjislacionin në fuqi, statutin dhe aktet e brëndshme të shoqërisë.
 - b) Ka për detyrë t'u përmbahet vendimeve të organeve drejtuese të "FED invest".
 - c) Nuk mund të shesë ose të blejë kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.
2. Kur anëtari i shoqërisë shkel normat e parashikuara në këtë statut dhe në aktet e brendshme rregullative të shoqërisë, ndaj tij merren masa të ndryshme disiplinore të parashikuara në aktet nënligjore të shoqërisë, në mënyrë logjike dhe proporcionale, deri në përjashtimin nga shoqëria.

Neni 22

Organet e shoqërisë

1. Organet e "FED invest" janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme.
 - b) Këshilli Drejtues.
 - c) Komiteti i Kontrollit.
 - d) Administratori (Drejtori Ekzekutiv).
2. Këshilli Drejtues mund të krijojë komitete për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për shoqërinë, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kompetencat, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës.

Neni 23

Asambleja e Përgjithëshme

1. Asambleja e Përgjithëshme e "FED invest" është organi vendimmarrës më i lartë i shoqërisë, dhe përbëhet nga delegatët e Njësive Bazë/Grup Njësive Bazë, të zgjedhur sipas rregullave të këtij Statuti dhe Kodit të Qeverisjes së shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
 - a) Vendos për politikën e drejtimit të shoqërisë lidhur me planin e biznesit dhe politikën buxhetore vjetore, të paraqitura nga Këshilli Drejtues.
 - b) Miraton pasqyrat financiare vjetore.
 - c) Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues, anëtarët e Komitetit të Kontrollit dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre.
 - d) Emëron dhe shkarkon audituesin ligjor të SHKK-së.
 - e) Miraton zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
 - f) Miraton statutin dhe ndryshimet e tij.
 - g) Vendos për fillimin e likuidimit vullnetar, të riorganizimit dhe shndërrimit, duke miratuar dhe likuidatorin për këtë rast.
 - h) Vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik, përfshirë edhe ndarjen, bashkimin etj..
 - i) Miraton raportet e Këshillit Drejtues, Komitetit të Kontrollit dhe raportin vjetor të aktivitetit të SHKK-së.
 - j) Trajton dhe vendos sipas rastit, për çështje të tjera që çmohen të rëndësishme nga Këshilli Drejtues.
3. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e shoqërisë dhe organet drejtuese të saj.

Neni 24

E drejta e votës dhe përfaqësimi

1. Në parim, çdo anëtar i shoqërisë ka të drejtën e një vote, pavarësisht shumës së kontributit të paguar në kapital apo shumës së depozituar në shoqëri.
2. Një anëtar mund të përfaqësohet në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të Njësive Bazë/Grup Njësive Bazë nga një anëtar tjetër apo nga një person i tretë, në bazë të një prokure të lëshuar nga anëtari, i cili përfaqësohet.
3. Një numër i caktuar anëtarësh përfaqësohen në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme

nga delegati.

4. Modalitetet e tjera, si dhe çdo gjë tjetër që lidhet me këtë proces, përcaktohet në aktet e brendshme të shoqërisë.

Neni 25

Asambleja e Përgjithshme e "FED invest"

1. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brënda 6 muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga:
 - a) Këshilli Drejtues.
 - b) Administratori (Drejtori Ekzekutiv).
 - c) Komiteti i Kontrollit.
 - d) Të paktën 10% (dhjetë për qind) e anëtarëve të shoqërisë, të cilët duhet të kenë paraqitur dhe nënshkruar kërkesën me shkrim në selinë qendrore të shoqërisë.
 - e) 30% (tridhjetë për qind) e delegatëve të Asamblesë.
3. Thirrja bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, postës elektronike, një njoftimi të afishuar në një vënd të dukshëm në zyrat e "FED invest" ose nëpërmjet botimit në gazeta, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Njoftimi duhet të përmbajë të paktën:
 - a) emërtimin e "FED invest", selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së Asamblesë;
 - b) rendin e ditës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 26

1. Projekt-Propozimet diskutohen në Asamblesë e Përgjithshme nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e votave të delegatëve.
2. Vendimet janë të vlefshme kur për Projekt-Propozimet janë siguruar shumica e votave të delegatëve (50+1 vota) që marrin pjesë në mbledhje.
3. Projekt-Propozimet për bashkimin apo shkrirjen në një subjekt tjetër apo likuidimin e shoqërisë, etj që kërkojnë maxhorancë të cilësuar, Asambleja e Përgjithshme i miraton me tre të katërtat e votave të delegatëve që marrin pjesë në mbledhje, kur prezent kanë qënë tre të katërtat e votave të delegatëve.
4. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të seancës është përcaktuese.
5. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin e saj për çdo mbledhje, me propozimin e Këshillit Drejtues.
6. Nëse Asambleja nuk vendos ndryshe, funksionet e Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues.
7. Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të realizohet për shkak të mungesës

së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri brënda ditës së nesërme, pavarësisht numrit të anëtarëve pjesëmarrës.

8. Në thirrjen e dytë, Asambleja do të quhet rregullisht e mbledhur, cilido qoftë numri i anëtarëve të pranishëm apo të përfaqësuar dhe merrë vendime shumicën e votave të të delegatëve (50+1 vota) që marrin pjesë në mbledhje.

Neni 27

Mbledhja e Përgjithëshme Vjetore dhe Bordi i Njesisë Bazë/Grup Njësie

1. Mbledhja e Përgjithëshme Vjetore e Njesisë Bazë/Grup Njesisë, përbëhet nga të gjithë anëtarët rezidentë brënda territorit të Njesisë Bazë (Degë/ZMA) me të drejtën e votës sipas parimit një anëtar/një votë. Thirrja e mbledhjes, procedurat, struktura e votimit dhe përcaktimi i modaliteteve të tjera, bëhen nga Këshilli Drejtues i "FED invest".
2. Si rregull, Kryetari thërret Bordin dhe përfaqëson Njesisë Bazë/Grup Njesisë në Asamblenë e Përgjithëshme, në përputhje me aktet e brëndshme të shoqërisë.
3. Bordi i Njesisë Bazë/Grup Njesisë diskuton rreth çështjeve që lidhen me aktivitetin e degës dhe programin e Asamblesë, përpara se këto çështje të paraqiten në Asamblenë e Përgjithëshme.

Neni 28

Përgjegjësitë e anëtarëve të organeve të SHKK "FED invest"

Anëtarët e Këshillit Drejtues, të Komitetit të Kontrollit dhe administratori i shoqërisë, duhet që në të gjitha rastet të veprojnë në mirëbesim, duke respektuar vendimet e Asamblesë së Përgjithëshme, normat e këtij statuti dhe të gjitha aktet e brëndshme të shoqërisë. Nëse ata nuk i respektojnë detyrimet e tyre, veprojnë gabim apo në keqbesim, ata detyrohen personalisht ose në mënyrë solidare, sipas legjislacionit, të ndreqin dëmin e shkaktuar shoqërisë.

Neni 29

Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të organeve të "FED invest"

Anëtari i Këshillit Drejtues, i Komitetit të Kontrollit apo administratori i shoqërisë, për të ushtruar funksionet e tyre, duhet të përmbushin të gjitha kërkesat ligjore dhe të mos refuzohen nga Banka e Shqipërisë.

Për zgjedhjen apo emërimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë, secili kandidat duhet të plotësojë, minimalisht, këto kriteret:

- a) Të jetë anëtar i shoqërisë, aktiv në një nga degët e "FED invest".
- b) Të ketë qëndrim të mirë moral, reputacion të lartë etik dhe profesional.
- c) Të ketë njohuri dhe eksperiencë në fushën bankare dhe/ose financiare.
- d) Të plotësojë të gjitha kërkesat e tjera specifike të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë dhe aktet e brëndshme të shoqërisë.

Kandidatët për organet drejtuese të shoqërisë mund të propozohen nga 10% (dhjetë përqind) e delegatëve të Asamblesë ose nga Këshilli Drejtues.

Anëtarët e Këshillit Drejtues, të Komitetit të Kontrollit dhe Administratori i “FED invest”, nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë funksion në organet drejtuese të një SHKK-je apo Unioni tjetër.

Neni 30 **Dorëheqja dhe shkarkimi**

1. Çdo anëtar i organeve drejtuese të “FED invest” mund të japë në çdo kohë dorëheqjen. Dorëheqja duhet të jetë e motivuar dhe t’i njoftohet me shkrim organit ku ai është anëtar.
2. Një anëtar i organeve drejtuese të “FED invest” mund të shkarkohet për shkelje të rënda, siç janë shkelje të akteve ligjore, nënligjore apo të statutit, akteve të brëndshme dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithëshme. Ai mund të shkarkohet me një vendim të arsyetuar nga organi i emërtesës.
3. Personi i shkarkuar mund të paraqesë pretendimet dhe kundërshtimet e tij në formë të shkruar, si dhe ka të drejtë të marrë fjalën për pretendimet e tij para organit që bën shkarkimin.
4. Organet e shoqërisë, sipas përcaktimeve ligjore dhe përkatësisë, mund të vazhdojnë funksionimin e tyre normal deri sa niveli i përbërjes (anëtarësisë) së tyre të shkojë në 2/3, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 31 **Kuorumi**

Kuorumi i kërkuar në mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe Komitetit të Kontrollit është shumica e anëtarëve të tyre.

Neni 32 **Vendimet**

1. Vendimet e Këshillit Drejtues dhe të Komitetit të Kontrollit merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Në rast ndarje të barabartë të votave në Këshillin Drejtues, vota e Kryetarit të seancës është përcaktuese.
3. Vendimet në Komitetin e Kontrollit merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve. Abstenimi nuk lejohet.
4. Vendimet shënohen në një proces-verbal të firmosur nga Kryetari dhe Sekretari. Emërimi i Sekretarit dhe modalitetet e tjera lidhur me vendimmarrjen, parashikohen në aktet nënligjore të miratuara respektivisht nga Këshilli Drejtues ose Komiteti i Kontrollit të shoqërisë.

Neni 33

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi ekzekutiv i shoqërisë, i cili drejton shoqërinë dhe përgjigjet para Asamblesë së Përgjithshme. Ai duhet të mbledhet të paktën një herë në tre muaj. Në çdo mbledhje të Këshillit mbahet një proces-verbal nga Sekretari i Këshillit.
2. Këshilli Drejtues e drejton shoqërinë brënda kompetencave që i njeh ligji, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, statuti apo çdo akt tjetër i brëndshëm që parashikon shprehimisht një të drejtë/detyrë.
3. Këshilli Drejtues mban përgjegjësi për operacionet dhe administrimin e drejtë të shoqërisë, dhe siguron respektimin e dispozitave të ligjit, statutit dhe akteve të tjera.
4. Këshilli Drejtues kryen funksionet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:
 - Zbaton vendimet e Asamblesë së Përgjithëshme.
 - Harton dhe miraton politikat financiare të shoqërisë.
 - Raporton mbi menaxhimin e “FED invest” në Asamblenë e Përgjithëshme.
 - Miraton aktet e brëndshme rregullative të funksionimit të shoqërisë.
 - Miraton strukturën dhe organigramën e shoqërisë.
 - Emëron Administratorin (Drejtorin Ekzekutiv) për një periudhë deri në 4 vjet, me të drejtë riemërimi.
 - Emëron/shkarkon Drejtorin e Departamentit të Financës (CFO), me propozim të Administratorit.
 - Kryen edhe funksione të tjera të përcaktuara nga ligji, aktet e Bankës së Shqipërisë, dhe aktet e tjera të brëndshme të shoqërisë.

Neni 34

Përbërja

1. Si rregull, Këshilli Drejtues përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithëshme e shoqërisë. Këshilli i parë Drejtues përbehet nga 7 (shtatë) anëtarë. Këshilli zgjedh Kryetarin e tij nga një nga anëtarët.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit ushtrohet për një periudhë kohe 4 (katër) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.
3. Një anëtar i Këshillit Drejtues mund të jetë njëkohësisht anëtar i Komitetit të Kontrollit.
4. Këshilli Drejtues mund të emërojë edhe këshilltarë/ekspertë të jashtëm.
5. Këshilltarët duhet të jenë specialistë/ekspertë të fushave, të cilat Këshilli i vlerëson të nevojshëm. Këshilli Drejtues përcakton edhe modalitetet e tjera lidhur me këto emërimet.

Neni 35

Thirrja e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues thirret dhe drejtohet nga Kryetari ose Zv/Kryetari në mungesë të tij, por jo më pak se 1 herë në tre muaj.

Neni 36

Komiteti i Kontrollit

1. Komiteti i Kontrollit është organi më i lartë monitorues/auditues për veprimtarinë financiare dhe administrative të "FED invest". Ai mbikëqyr të gjitha veprimet financiare të kryera dhe sigurohet që Këshilli Drejtues të marrë vendime sipas statutit dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Komiteti i Kontrollit ka kryesisht këto kompetenca:
 - a) Kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të shoqërisë, përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë.
 - b) Bën vlerësimin e situatës financiare të shoqërisë, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të regjistruar.
 - c) Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë me aktet ligjore e nënligjore dhe njofton për përfundimet Këshillin Drejtues.
 - d) Miraton raportet dhe deklaratat financiare, të përgatitura nga shoqëria, me qëllim publikimin e tyre.
 - e) Kontrollon administrimin financiar dhe vlerëson rreziqet operacionale.
 - f) Shqyrton të gjitha çështjet që mund t'i jenë parashtruar nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Komiteti i Kontrollit njofton me shkrim Këshillin Drejtues për çdo shkelje që konstaton në funksionimin e shoqërisë.
4. Komiteti i Kontrollit mblidhet jo më pak se tre herë në vit, në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Drejtues. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve. Abstenimet nuk lejohen.
5. Mënyra e funksionimit dhe veprimtaria e tij, si dhe çdo modalitet tjetër, parashikohen në rregulloren e Komitetit të Kontrollit.

Neni 37

Përbërja e Komitetit të Kontrollit

1. Komiteti i Kontrollit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, për 4 (katër) vjet me të drejtë rizgjedhje. Komiteti i Kontrollit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij mund të emërojë ekspertë të fushës.
2. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit janë individë, ekspertë të fushës, të cilët duhet të kenë eksperiencë jo më pak se 3 vjet në fushën e kontabilitetit, të auditimit ose financiare.

Neni 38

Administratori (Drejtori Ekzekutiv)

1. Këshilli Drejtues emëron Administratorin e shoqërisë për një periudhë 4 (katër) vjeçare, me të drejtë riemërimi.
2. Administratori ushtron kompetencat duke u bazuar në ligj, në aktet e Bankës së Shqipërisë, si dhe në aktet e brëndshme të shoqërisë.
3. Administratori mund të autorizojë persona të tjerë për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.
4. Këshilli Drejtues mund të shkarkojë administratorin në çdo moment, në rast se nuk përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Në çdo rast do të respektohen procedurat e parashikuara në aktet e shoqërisë, për të siguruar një trajtim objektiv dhe të paanshëm të fakteve dhe rrethanave.
5. Administratori, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.
6. Emërimi i administratorit krijon pasoja juridike pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 39 **Audituesi ligjor**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron audituesin ligjor të shoqërisë, bazuar në rekomandimet e Këshillit Drejtues.
2. Shoqëria njofton zyrtarisht Bankën e Shqipërisë për emërimin, zëvendësimin e audituesit ligjor dhe ky i fundit njofton zyrtarisht Bankën e Shqipërisë kur jep dorëheqjen.
3. Shoqëria ndryshon audituesin ligjor, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar. Shoqëria do të zbatojë edhe aktet e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

Neni 40 **Viti financiar**

1. Viti Financiar fillon në datën 1 janar dhe mbaron në datën 31 dhjetor të të njëjtit vit kalendarik. Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar, i cili vlerësohet në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Këshilli Drejtues i shoqërisë, brënda 6 mujorit të parë të çdo viti, i paraqet Asamblesë së Përgjithëshme pasqyrat financiare të vitit paraardhës, për shqyrtim dhe miratim.

Neni 41 **Kontabiliteti**

Shoqëria e organizon kontabilitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me aktet e Bankës së Shqipërisë, si dhe standartet më të mira

ndërkombëtare.

Neni 42 **Raporti vjetor**

Shoqëria, në përfundim të vitit financiar, duhet të paraqesë një raport vjetor të veprimtarisë së saj. Ky raport përmbledh kryesisht gjëndjen financiare të saj dhe shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithëshme.

Neni 43 **Mosmarrëveshjet**

Të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve që mund të krijohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, do të synohet të zgjidhen me mirëkuptim, në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, dhe me standartet më të mira të komunikimit. Në çdo rast do të merren në konsideratë interesat e shoqërisë.

Neni 44 **Funksionimi i brëndshëm i shoqërisë**

Mënyra e funksionimit dhe e veprimtarisë së përditëshme të shoqërisë, si dhe çdo gjë tjetër që nuk është parashikuar në këtë statut, do të parashikohet në aktet e brëndshme rregullative të shoqërisë.

Neni 45 **Depozitimi i Statutit**

Ky Statut është hartuar në 5 (pesë) kopje. Nga këto, një kopje dërgohet në Bankën e Shqipërisë, një kopje në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, dhe një kopje depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 46 **Miratimi i Statutit**

Ky Statut u miratua nga Asambleja e Përgjithëshme e "FED invest", më datë 29 Prill 2017. Me miratimin e tij shfuqizohet statuti i vjetër i shoqërisë.

KRYETARI I ASAMBLESE

Mehdi PEPA